



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 266 prot.

Himarë, më 30.05.2022

V E N D I M

Nr. 28 datë 27.05 2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË SË HIMARËS, 2022-2025**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "a", pikës 1, të nenit 28, gërmës "a", të pikës 2, të nenit 33, të gërmës "k", të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar, të ligjit nr. 8778/2001 "Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, të ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave", të ndryshuar, të ligjit nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të VKM-së nr. 247, datë 20.03.2015, për "Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2023", të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit të Integritetit në Bashkinë e Himarës 2022-2025, sipas materialit të përgatitur nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr.151 prot., datë 03.08.2021, të Kryetarit të Bashkisë së Himarës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit është drejtori i drejtorisë së përgjithshme të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, i cili ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit të Bashkisë së Himarës, për veprime që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cënimin e integritetit të institucionit.

3. Punonjësit e Bashkisë së Himarës, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e tij, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit në fuqi.

4. Në fund të vitit kalendarik, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit duhet të paraqesë para Këshillit Bashkiak një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.

5. Ngarkohet e gjithë struktura organizative në Bashkinë e Himarës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI  
Dhimitër Kapaaj

